**VENDIM**
**Nr.445, datë 16.6.2005**

# PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË PUNËS DHE TË ÇËSHTJEVE SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale.

Lista përbëhet nga 1 (një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

Institucioni i Pushtetit Qendror **MINISTRIA E PUNES DHE ÇESHTJEVE SOCIALE** Identifikoi SPARTAK GJINI

Bashkia/Komuna **BASHKIA TIRANE** Supervizor ASQERI KISHTA

Fusha e perdorimit te prones **ZYRA TE MINISTRISE** Aprovoi

| | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr Rend | Zona Kadastr & Indeksi i Hartes | Nr. i pasur. | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m2) | Nga Sip. totale sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret prona | Institucioni / Entitet me pergjegjesi administrative | Institucioni / Entiteti perdorues ... perdorimit | Te dhena te tjera shtese te vecanta |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| | | | | Ndertese administrative, me 1,2 dhe 5 Kate dhe oborri i saj. | 1095.62 | 612.74 | Zyra te Ministrise se Punes dhe Ceshtjeve Sociale | Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale | Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale Pronar | Siperfaqe totale e ndertimit St.Nd=2233.76 m2 |